

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-24-1003-5-2-5/C1344

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"EdiBau- ing " SH.P.K., UKË BYTYÇI PN, PRIZREN, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren me numër identifikues: 622-24-1003-5-2-5

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren**

No.	Lot
1	Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **16,932.95 € (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntqind e tridhjetë e dy euro e nëntëdhjetë e pes cent)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.


dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.02.2024
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Bujar Spahija
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	27.02.2024
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-1003-5-2-5/C1344

K/K në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 2 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 20 ditë pune
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Luljeta Veselaj Gutaj Drejtoreshë në DASH Menaxheri i Kontratës është: Veron Aliu IDA në DASH
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-1003-5-2-5

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: " **EdiBau- ing** " **SH.P.K., UKË BYTYÇI PN, 20000, PRIZREN, Kosovë**

E-mail: **edibauing@gmail.com**

Personi kontaktues: **Bujar Spahija**

Telefoni: **044/144454**

049/380600

Faxi:

Numri fiskal: **601597779**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-1003-5-2-5

Titulli i kontratës: Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren

3. Çmimi total i tenderit është:

16,932.95 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **60** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e

Paramasat për punimet shtesë në shkollën Lekë
Dukagjini

I. PUNËT PREGADITORE DHE DEMOLUESE					
PUNET DEMOLUESE:					
Poz. I	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.2	DEMOLIMET NË OBJEKTIN E SHKOLLËS				
1.2.2	Demontimi i dyerve egzistuese nga druri në Bodrum, Perdhesë dhe K1, në pozicionet e caktuara në projekt. Dyert janë me dimensione 100x205 cm. <i>Materialet e demoluara të cilat nuk ka nevojë të ruhen (të deponohen në një vend që e cakton organi mbikëqyres) atëherë ato të transportohen jashtë kantierit të ndërtimit, të hudhen në deponi mbeturinash, në një lokacion ku e cakton komuna, nëse duhet të paguhet për hudhje të materialit të rrenuar, kjo ngarkesë financiare bie mbi OE.</i> <i>Materialet e demontuara të cilat duhet të ruhen dhe të deponohen në vendin të cilin e cakton organi mbikëqyres.</i>	cope	4.00	5.00	20.00
1.2.6	Demontimi i dyerve egzistuese nga metali në Bodrum dhe hyrje të Salles së Ed. fizike, në pozicionet e caktuara në projekt. <i>Materialet e demoluara të cilat nuk ka nevojë të ruhen (të deponohen në një vend që e cakton organi mbikëqyres) atëherë ato të transportohen jashtë kantierit të ndërtimit, të hudhen në deponi mbeturinash, në një lokacion ku e cakton komuna, nëse duhet të paguhet për hudhje të materialit të rrenuar, kjo ngarkesë financiare bie mbi OE.</i>	cope	1.00	5.00	5.00
1.2.17	Demolimi i mureve egzistuese nga blloqet e argjilës me dimensione të trashësisë 12 cm dhe 15 cm. Lartësia e katit është 3.50 m. Demolimi të bëhet në pozicionet e paraqitura sipas projektit. Në cmim të kalkulohet edhe skelëria e nevojshme për demolim. <i>Verejtje: Gjate demolimit të kushtohet vëmendje të vecante instalimeve elektrike të cilat mund të jenë në mure, dhe të mos demtohen dyshemetë, tavanet etj.</i> <i>Materialet e demontuara të cilat duhet të ruhen dhe të deponohen në vendin të cilin e cakton organi mbikëqyres.</i> <i>Materialet e demoluara të cilat nuk ka nevojë të ruhen (të deponohen në një vend që e cakton organi mbikëqyres) atëherë ato të transportohen jashtë kantierit të ndërtimit, të hudhen në deponi mbeturinash, në një lokacion ku e cakton komuna, nëse duhet të paguhet për hudhje të materialit të rrenuar, kjo ngarkesë financiare</i>	m ²	118.10	5.00	590.50



1.2.20	Gerryerja dhe pastrimi i suvatimit ne muret tek te cilat eshte paraqitur lageshtia e mureve. Gerryerja duhet te behet deri ne blloka ekzistues dhe duhet te parapregaditet per risuvatimin e pjeseve te gerryera. Materialet e demoluara te cilet nuk ka nevojte te ruhen (te deponohen ne nje vend qe e cakton organi mbikqyres) atehera ato te transportohen jasht kantierit te ndertimit, te hudhen ne deponi mbeturinash, ne nje lokacion ku e cakton komuna, nese duhet te paguhet per hudhje te materialit te rrenuar, kjo ngarkes financiare bie mbi DE	m ²	2,080.04	2.00	4,160.08
				TOTALI	4,775.58
2. PUNËT E RENOVIMIT					
2.1	PUNET E RENOVIMIT NE OBJEKT EKZISTUES				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1.7	Furnizimi me material si dhe gletimi i mureve te banjove mbi pllaka te keremikes, te punohet sipas standardeve me te gjitha materialet-shtresat tjera adekuat. Gletimi perfshine, perpos pjese se aneksit edhe permiresimet e nevojshme ne kthinat ekzistuese.	m ²	1,997.37	1.00	1,997.37
2.1.8	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe tavaneve të objektit ne hapësirat e klasave, koridoreve, administrates, salles se ed fizike etj me ngjyrë dy komponentale (tek hapësirat e suvatuara me llaq gelqeror) duke përfshirë edhe lyerjen paraprake me "Primer" adekuat). Ngjyra duhet te aplikohet ne te gjitha siperfaqet e mureve te punuara me glet, perpos ne pjeset ku aplikohet ngjyra yndyrore. Ne keto pozicione ngjyrosen muret nga lartesia 150 cm deri ne plafon. Norma EN 13300	m ²	3,200.00	1.00	3,200.00
2.1.14	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve të nyjeve sanitare me pllaka të paglazura qeramike me dimensione 45x90x0.8 cm, me ngjyrë dhe teksturë të përcaktuar nga organi mbikqyrës. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues, me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m ²	105.29	17.00	1,790.00
DYER NGA DRURI Furnizimi dhe montimi i dyerve. Paneli: Panel i presuar nga ashklat e drurit me trashësi 40 mm i veshur me llamarinë 0.8 mm. Korniza e derës: dypjesëshe - profili me gjerësi fikse ose profil teleskopik pë gjerësi të ndryshueshme nga llamarina me trashësi 1.5 mm Profili i mesëm: çelik Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak në formë rozete Mënteshat: tipi VX - 3 pjesësh me ngjyrë kromi mat Xhami: Transparent - 6 mm (ku eshte i parapare me skema). Ngjyradhe tekstura: Te perzgjedhet nga organi mbikqyres					
2.1.15	Derë e klasës /njekrahesh/ 100x205 cm	cope	2.00	210.00	420.00

2.1.17	Derë e klasës /dykraheshe/ 180x200 cm	cope	1.00	250.00	250.00
SANITARIA DHE TRUPAT NDRICUES					
2.1.28	Furnizimi dhe vendosja e llampave ndriqese, montimi ne plafon, 4x18W, shtepiza nga Glass-reinforced polyesteri, IP 40, (LxVxH) 400x400x100mm.	cope	80.00	25.00	2,000.00
TOTALI					9,657.37
3	DEPOJA E KALDAJËS DHE RAMPA				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.9	PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES				
3.9.1	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të mbrendshme ne te gjitha nivelet me suva te gateshme, te punohet sipas standardeve duke perdore shtresat e nevojshme, te perdoret rrjete gjate suvatimit si dhe kendet adekuate. Suvatimi perfshine, perpos pjese se aneksit edhe permirosimet e nevojshme ne kthinat ekzistuese.	m ²	500.00	4.00	2,000.00
TOTALI					2,000.00
3.11	PUNET E ZDRUKTHTARISE				
	DYER NGA METALI JO TERMIK Furnizimi prodhimi dhe montimi i dyerve nga Metali pa urë termike me guma dhe aksesori perçjelles. Profilat e aluminit të ngjyrosur me ngjyrë të percaktuar nga organi mbikqyres. Krahu i derës është nga paneli i llamarinës se aluminit t-10 mm ne kornizën përkatëse. Hapjet bëhen sipas skemave te dhëna. Dera të paiset me bagllamë te kualitetit te larte. Sistemi duhet te mbështet me certifikata dhe ateste adekuate për secilin pozicion.				
3.11.2	D2 /njekraheshe/ 100x210 cm	cope	2.00	250.00	500.00
TOTALI					500.00

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM		
A	ARKITEKTURA	
	Përshkrimi i pozicionit	Shuma
	1. PUNËT PREGADITORE DHE DEMOLUESE	4,775.58 €
1.2	DEMOLIMET NË OBJEKTIN E SHKOLLES	4,775.58 €
	2. PUNËT E RENOVIMIT	12,157.37 €
2.1	PUNET E RENOVIMIT NE OBJEKT EKZISTUES	9,657.37 €
	DEPOJA E KALDAJËS DHE RAMPA	2,500.00 €
3.9	PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES	2,000.00 €
	PUNET E ZDRUKTHTARISE	500.00 €
	TOTALI I PERGJITHSHEM	16,932.95 €





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **122551**

Për **Komuna e Prizrenit**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **EdiBaU- Ing SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren**

Nr. prokurimit: 622-24-1003-5-2-5

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,693.30€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,693.30€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 60 ditë kalendarike prej **26.02.2024** deri më **26.04.2024**

Data lëshimit: 26.02.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit




Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

NJOFTIM PËR KOMISIONIN RREGULLTIVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Sipas Nenit 35.1 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për	Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik
Përmes	Z. Shaqir Totaj Kryetar (ZKA  
Nga	Isa Osmankaj Udhëheqës i sektorit për prokurim
Lënda	Njoftim për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë
Titulli i aktivitetit të prokurimit	Aneks kontratë për renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukagjini në Prizren
	622-24-1003-5-2-5
Data	12. 02. 2024

Sipas nenit 35.2 të LPP, autoriteti kontraktues, pa ndonjë qëllim për të diskriminuar kundër apo në favor të ndonjë operatori ekonomik, ka përdorur Procedurën e Negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë. Arsyeja për marrjen e këtij vendimi:

Neni 35.2.4(i): zbatimi ose ekzekutimi i shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën ...

SHPJEGIM

[Ofro shpjegim të detajuar për arsyet dhe faktorët të cilët janë marrë parasysh në marrjen e vendimit për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë]

Komuna e Prizrenit ka nënshkruar një kontratë bazë për Renovimin e objektit të shkollës fillore Lekë Dukaxhini në Prizren . me nr të prokurimit 622-23-1960--5-1-1. Kontrata në fjalë ka vlerën prej 194,395.81 euro € dhe është duke u realizuar por gjat ekzekutimit të kësaj kontrate kan dal punë të paparapara as me projekt e as me paramasa, andaj AK ka lejuar që të realizohen punime shtesë në vlerën e përafërt me 10 % % të vlerës së përgjithshme të kontratës bazë

INFORMATAT SHITESË:

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka të drejtë të kërkoj çdo informatë shtesë të nevojshme nga Autoriteti Kontraktues

Zyrtari i Prokurimit: *Isa Osmankaj*

Nënshkrimi: 

Informatat kontaktuese:

Tel: 03820044704

E-mail: isa.osmankaj@rks-gov.net